

# LUTJET PËR SHËRIM

(Përpiloi P. Rufus Pereira)

Biblioteka: "Burimi i Jetës", libri 5.  
Titulli i origjinalit: **Prayer for healing**  
Përkthyer: M. Svjetlana Rezo, FDC, dhe  
Gjon Kelmendi ida  
Lektura: Fra Lovro Gavran, OFM  
Korrektura: P. Marjan Lorenci, OFM



## Parathënie

Libërthin «Lutjet për shërim» ma ka dhuruar pater Rufus Pereira, zëvendës i egzorcistit kryesor në Vatikan. Dhe, ja tani, falënderit Zotit, provanisë së Tij dhe bashkëpunëtorëve të bibliotekës «Burimi i jetës», e kemi edhe në gjuhën shqipe.

Duke u lutur në gjuhën angleze, e entuziazmuar pa masë, e kam përkthyer në kroatisht, kopjuar dhe shpërndarë të gjithëve që dëshironin të luten. Më pas, dikush ka ndihmuar materialisht, e kemi shtypur dhe ndarë 5000 kopje në seminarin e pater James-it në Travnik. Dhe ja tani i shpërndajmë 2000 kopje në gjuhën shqipe, duke ju falënderuar vëllezërve Françeskanë, të cilët e kanë ndihmuar këtë projekt.

Libërthi mund të porositet në shenjtëroret e Shën Antonit në Gjakovë dhe në Laç. Mund ta keni me vete gjithkund dhe ta përdorni në çdo situatë, madje dikush tha se duhet ta ketë në xhep secili besimtar.

Lutuni Zotit me besim të plotë, sepse Zoti ynë është i mirë, i mëshirshëm dhe i gjithpushtetshëm. S'ka gjë të pamundshme për Zotin.

«Për këtë arsye i përkul gjunjët e mi para Atit, prej të Cilit merr emrin e vet çdo atësi në qiell e mbi tokë, që të denjohet, në saje të begatisë së Lavdisë së vet, t'ju forcojë me anë të Shpirtit të Vet në fuqi për të mirën e njeriut të brendshëm, që Krishti të banojë në zemrat tuaja me anë të fesë në mënyrë që, të rrënjosur e të themeluar në dashuri, të mund ta kuptoni bashkë me të gjithë shenjtërit çka është Gjerësia, Gjatësia, Lartësia dhe Thellësia e ta merrni vesh dashurinë e Krishtit që kapërcen çdo dije kështu që të mbusheni me tërë plotësinë e Hyjit. E Atij, që, në saje të fuqisë që vepron në ne, mund të bëjë shumë më tepër se ne mund të kërkojme ose edhe mund të mendojme, Atiji i qoftë Lavdi në Kishën e Jezu Krishtit në të gjitha brezitë e jetës së jetëve. Amen!» (Ef 3,14-21).

Pasi që, ndoshta, për disa besimtarë, ky do të jetë libër i vetëm i lutjeve, i kam shtuar edhe lutjet tona themelore, si edhe lutjen e të lumit kardinal Alojz Stepinac, dhe lutjen Zojës, që ma ka dhënë motra Bridge McKena, kështu që e mira shpirtërore me begati të shkëmbehet në Kishë – trupin e Krishtit.

M. Svjetlana Rezo, FDC

## Lutjet themelore (tradicionale)

### Në emër të Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjt. Amen.

**Ati ynë**, që je në Qiell, u shenjtëroftë emri yt, ardhhtë Mretëria jote, u bëftë vullnesa jote: si në qiell, ashtu në tokë!

– Bukën tonë të përditshme na e jep sot. Na i fal fajet tona, si i falim ne fajtorët tanë. E mos na ler të biem në tundim, por na liro nga i Keqi. Amen.

**Të falemi, Mari**, hirplote, Zoti me ty! E bekuar je mbi të gjitha gratë, dhe i bekuar fryti i barkut tënd, Jezus.

– Shenjta Mari, Nëna e Tenzot, lutu për ne mëkatarët, tash e në fill të vdekjes sonë. Amen.

### Lavdi Atit, e Birit e Shpirtit Shenjt!

– Si ka qenë në fillim, ashtu tash e përgjithmonë e jëtës. Amen.

**Besoj në Tenzon**, Atin e gjith-pushtetshëm, Krijuesin e qiellit e të tokës. E në Jezu Krishtin, Birin e tij një të vetmin, Zotin tonë. I cili u zu për virtyt të Shpirtit Shenjt. U lind prej Virgjërës Mari. Pësoi mundimet nën Poncin Pilat. U vua në kryq, vdiq e u varros. Zbriti mbi ferr. Të tretën ditë u ngjall së vdekuri. U ngrit në qiell. Rri në anë të djathtë të Tenzot, Atit të gjithpushtetshëm. Andej do të vijë për të gjykuar të gjallët e të vdekurit. Besoj në Shpirtin Shenjt, Kishën e shenjtë katolike, shoqërinë e shenjtërve, faljen e mëkateve, ngjalljen e të vdekurve dhe jetën e pasosur. Amen.

### Puna e pendimit

O Zoti im, po më vjen keq me gjithë zemër për të gjitha mëkatet që i kam bërë: se kam bjerrë parrizin, kam merituar ferrin. Por më fort po më vjen keq se Të kam fyer Ty, o e mira e pambaruar, që kaq fort më ke dashur. Mëshirë, o Zot! Më fal, o Zot! Po Të jap fjalën, se me ndihmë Tënde, nuk do Të fyej më kurrë. Amen.

## LUTJET PËR SHËRIM (nga P. Rufus Pereira)

### 1. Lutja e kushtimit

Abba, o Atë! Po Ta kushtoj (emëri i përsosur); anëtarët e familjes sime; shtëpinë time; ankthet dhe problemet e mia; armiqët e mi dhe të gjithë bashkëkombasit e mi, Zembrës Eu-karistike të Jezusit dhe Zembrës së Papërlyer të Virgjërës Mari. Na ndihmo ta përjetojmë përtëritjen shpirtërore ashtu që të jetojmë një jetë të pastër dhe të shenjtë. Shëndërroji të gjitha problemet dhe vështirësitë në dobinë tonë dhe në lavdinë Tënde më të madhe. Amen!

## 2. “Abba – O Atë” (1)

O Ati im qiellor, sa mirë është kur e di se Ti je Ati im dhe se unë jam fëmija yt! Sidomos kur qielli i shpirtit tim është i vërenjtur dhe kryqi im duket më i rëndë, ndjej nevojën që Të drejtohem: “Atë, besoj në dashurinë tënde ndaj meje!”

Po, besoj se Ti je Ati im në çdo moment të jetës sime, dhe se unë jam fëmija yt! Besoj se më do me dashurinë tënde të pakufi!

Besoj se Ti kujdesesh për mua ditë e natë që as një qime floku të mos më bjerë nga koka pa lejen tënde!

Besoj se Ti në dashurinë Tënde të pakufi, e di më mirë se unë, se çka është më mirë për mua.

Besoj se Ti në fuqinë tënde të pakufi, mund të kthesh edhe të keqen në të mirë.

Besoj se Ti në mirësinë tënde të pakufi ua kthen çdo gjë në të mirë atyre që Të duan; madje edhe nën duart që më rrahin, unë e puth dorën Tënde që shëron!

Unë besoj dhe lutem të forcosh fenë, shpresën dhe dashurinë time! Më mëso që gjithmonë ta shoh dashurinë tënde në të gjitha lëmitë e jetës sime.

Më mëso që të lëshohem në duart tua si fëmija i vogël në duart e nënës. Atë Ti di çdo gjë. Ti sheh çdo gjë. Ti më njeh më mirë se unë vetveten; Ti mund të bësh çdo gjë dhe Ti më do. Ati im, dëshira Jote është që Ty të drejtohem gjithmonë. Po vij me besim së bashku me Jezusin dhe Marinë... *(Këtu kërko hirin që dëshiron).*

Në këtë nevojë po lidhem me Zemrat e tyre tejet të shenjta dhe T'i paraqes të gjitha lutjet e mia, sakrificat e mia, nënçmimet dhe vuajtjet, të gjitha veprat e mia dhe besnikërinë ndaj thirrjes sime.

Më jep dritën, hirin dhe forcën e Shpirtit Shenjt! Më forco në shpirtin tim që kurrë të mos e humbas dhe kurrë të mos lejoj që të jetë i pikëlluar dhe i paaftë në mua. Ati im, këte të lus në emër të Jezusit, Birit Tënd. Ti, Jezus i dashur, hape zemrën Tënde dhe në të vendose timen, dhe së bashku me zemrën e Marisë paraqitja Atit tonë qiellor! Më dhuro hirin që më duhet!

O Atë qiellor, thirri tek vetja të gjithë njerëzit. Le të shpallë mbarë bota mirësinë Tënde atërore dhe mëshirën Tënde Hyjnore!

Në butësinë Tënde më ruaj në çdo gjë që kam dhe jam, si bebëzën e syrit Tënd. Bëj që të jem fëmijë i denjë, ki mëshirë për mua!

Atë qiellor, shpresa e ëmbël e shpirtave tanë, qofsh i njohur, i nderuar dhe i dashur nga të gjithë njerëzit!

Atë qiellor, dhurues i mëshirës mbarë njerëzimit, qofsh i njohur, i nderuar dhe i dashur nga të gjithë njerëzit!

## 3. “Abba – O Atë” (2)

Abba, o Atë, Ty po Ta kushtoj këtë ditë dhe vihem nën mbrojtjen tënde.

Më përdor që nëpër mua të jesh i njohur, i nderuar dhe i dashur nga të gjithë njerëzit.

Le të flasim veprat e mia për dashurinë tënde.

Gjuha ime le Të lëvdojë në të gjitha situatat dhe mendimet e mia le të jenë të frymëzuara vetëm me Ty.

Ati im, unë Të dua Ty mbi të gjitha. Amen.

## 4. Lutja e mëngjesit, e drejtuar Atit – Abba

Ati im, po vij në praninë Tënde, në fillimin e kësaj dite.

Po vij të gjej **urtinë**, që të mos bëj gabime të pamenduara, ashtu që të di kur duhet të flas e kur të rri në heshtje, kur të veproj e kur jo.

Po vij të gjej **paqen** ashtu që sot asgjë të mos më brengosë as të më pengojë.

Po vij që të gjej **guximin** që të jem i durue-shëm, që të mos e humbas shpresën, që ta pranoj zhgënjimin, duke e ditur se Ti do të kthesh çdo gjë në të mirën time.

Po vij që të gjej **dashurinë**, kështu që asgjë të mos bëjë që të jem i zemëruar, i pandjeshëm dhe i panjerëzishëm.

Erdha që të filloj këtë **ditë** me Ty dhe dëshiroj që ta vazhdoj me Ty, ashtu që kjo të jetë ditë pa asnjë të keqe.

Atë, Ti je kujdestari im, e di se Ti do të kujdesesh për të gjitha nevojat e mia.

Atë, Ti je mbrojtësi im, më ruaj sot nga të gjitha sulmet e fuqive të errëta, më mbulo me Gjakun tejet të çmueshëm të Birit Tënd Jezusit dhe më rretho me engjëjt e tu. Këte po të lus në emër të Jezusit. Amen!

## 5. Kushtimi i Zemrës së Jezusit Atit qiellor

*(Nga Chamboni. Thuhet zakonisht në mbrëmje)*

Atë i amshuar, po Ta paraqes nëpërmes Zemrës së Pamëkat të Marisë, Zemrën Tejet të Shenjtë të Jezusit, me tërë Dashurinë e Tij, me të gjitha vuajtjet e Tija, dhe me të gjitha meritat e Tija, si dëmshpërblim për mëkatet që kemi bërë *(ne dhe të tjerët)*, gjatë tërë jetës sonë, e sidomos gjatë kësaj dite *(jave, muaji...)*

**Lavdi Atit e Birit...**

Që të pastrosh dhe të fisnikërosh të gjitha veprat tona të mira, të cilat nuk i kemi bërë si duhet gjatë tërë jetës sonë, e sidomos gjatë kësaj dite *(jave...)*.

**Lavdi Atit e Birit...**

Që të kompensojmë për të gjitha veprat e mira *(lutjet, sakramentet, Meshën e shenjtë, frymëzimin, detyrat profesionale)*, të cilat është dashur që t'i bëjmë, dhe të cilat nuk i kemi bërë gjatë tërë jetës sonë, e sidomos gjatë kësaj dite *(jave...)*.

**Lavdi Atit e Birit...**

**Zoti im, ne besojmë në Ty, ne Të adhurojmë, ne shpresojmë në Ty, ne Të duam, dhe kërkojmë falje për të gjithë ata shpirta që nuk besojnë në Ty, që nuk Të adhurojnë, që nuk shpresojnë në Ty dhe që nuk të duan.**

## 6. Lutja Shpirtit Shenjt (1)

*(Thuaje në mënyrë meditative)*

Shpirti Shenjt, dielli i shpirtit tim, jeta e jetës sime, unë Të adhuroj, Të nderoj dhe përkulem para Teje.

**Më udhëheq** në të gjitha punët dhe ndërmarrjet e mia. *(Përmendi ato kryesore.)*

**Më forco** që t'i mbizotëroj të gjitha dobësitë e mia. *(Përmendi dobësitë e veçanta.)*

**Më ngushëllo** në të gjitha zhgënjimet dhe mossukseset e mia. (*Përmendi*).

**Më pastro** nga të gjitha mëkatet e mia (*sidomos nga...*). Krejtësisht më pastro dhe më bëj të shenjtë.

**Më shëro** nga të gjitha plagët e mia fizike, ndjenjësore dhe shpirtërore. (*Përmendi lëmitë e veçanta*).

Më ndihmo që të mund t'i fali të gjithë që më kanë lënduar. (*Kujto emrat e tyre, fali dhe kërko falje*). Më udhëheq në rrugën e Atit tim. Ma zbulo Jezusin, Shpëtimtarin tim. M'i hap sytë dhe zemrën për Fjalën e Zotit. Më mëso të lutem. Më ndihmo të dua ashtu si ka dashur Jezusi.

## 7. Lutja Shpirtit Shenjt (2)

(*E shën Augustinit*)

Më frymëzo, o Shpirt Shenjt, që mendimet e mia të jenë të shenjta.

Më lëviz, o Shpirt Shenjt, që puna ime të jetë e shenjtëruar.

Tërhiqe zemrën time, që të dua vetëm ate që është e shenjtë.

Më mbro, o Shpirt Shenjt, që të mund të jem i shenjtë gjithmonë.

## 8. Lutja Shpirtit Shenjt (3)

Eja, o Shpirt Shenjt, shndërroji tensionet tona në paqen e shenjtë të lumturisë.

Shndërroji mendimet dhe fatkeqsitë tona në prehjen e shenjtë.

Shndërroji ankthet tona në shpresë të qetë.

Shndërroji frikat tona të brendëshme në fe të fortë.

Shndërroje trishtimin tonë të brendshëm në ëmbëlsinë e hirit.

Shndërroje terrin në ne në dritë të butë.

Shndërroje ftohtësinë tonë në ngrohtësi të këndëshme.

Shndërroje natën në dritën tënde.

Shndërroje dimrin në ne në pranverën tënde.

Mënjano prapësitë, pandershmëritë tona, plotëso zbrastësitë e brendshme.

Zvogëlo kufijtë e krenarisë sonë, zgjëro kufijtë e përvuajtërisë sonë.

Ndize zjarrin e dashurisë sate, fike flakën e lakmisë.

Bëj që ta shohim veten ashtu si na sheh Ti, dhe që ta shohim Zotin ashtu si na është premtuar me Fjalën e amshuar:

“Lum ata që janë të pastër në zemër, sepse do ta shohin Hyjin” (*Mt 5, 8*).

## 9. Shenjtërueshmes Trini

(*Para Jezusit Eukaristik*)

O e Shenjtërueshmja Trini: Atë, Bir, dhe Shpirt Shenjt, Të adhurojmë thëllë, (*sipas mundësisë me përulje deri në tokë*) dhe po Ta paraqesim të paçmueshmin Korpin e Gjakun, Shpirtin, Njerëzinë dhe Hyjninë, e Zotit tonë Jezu Krishtit, të pranishëm (*këtu dhe*) në të gjithë tabernakujt e botës, si dëmshpërblim për mëkatet me të cilat Të fyejmë.

Dhe Të lusim, nëpër meritimet e të njëjtës Zemër të Jezusit dhe me ndërmjetësinë e Zembrës së Pamëkat të Marisë, ki mëshirë për mëkatarët e shkretë dhe ktheji ata, na ktheni ne, famullinë tonë dhe mbarë popullin tonë!

(*Thuhet tri herë. Mund të lutet edhe prej larg por me shpirt para tabernakullit.*)

## 10. Lutja për lirim nga i Keqi

“*Gjithçka është e mundshme për atë që beson!*”

Jezu Krisht, Zot i vërtetë e njeri i vërtetë, ti që ke arrdhur në botë për të shpëtuar njeriun, për ta liruar nga robëria e djallit dhe mëkatit, dhe nga vdekja e amshuar, dhe, duke paguar për mëkatet tona, prej kryqit na e ke hapur derën e parajsës – dhe me pagëzim na ke dhuruar Shpirtin Tënd që të jetojmë në lirinë e fëmijëve të Zotit – Ty tani po Ta drejtoj lutjen time të përvuajtë.

E pranoj: mëkatova dhe bëra të keqen para Teje. Besimi im në Ty ka qenë aq i vogël, e dashuria ndaj Teje edhe më e mjerë. Edhe pse kam thënë se i bie mohit djallit dhe veprave të tija – jeta ime ka qenë e mbushur me mëkat. Ti, me fajin tim, nuk ke qenë Zoti im, as jeta ime, as gëzimi im... Para Teje ka qenë UNI im, egoizmi im, kënaqja e pasioneve të mia, aq shumë idhuj, njerëz dhe gjëra.

Më fal, më fal o Jezus, nuk e kam ditur se Ti je Jeta, e Vërteta dhe Paqja! Në shqetësimet e mia të mundimshme, u drejtova fallxhinjve modernë dhe shërbëtorëve bestytë të të Keqit, dhe gjeta mundim e shqetësim edhe më të madh! Vërtet, veshët e mi kanë dëgjuar fjalët e Ungjillit Tënd, por krenaria ime dhe zemra përplot papastërti, nuk kanë lejuar që ato të depërtojnë në mua...

E tani kur rrezja e dritës dhe e dashurisë së Zembrës Sate të mëshirshme – oh, Zot, çfarë mëshire! – e ka prekur zemrën time, pranoje këtë klithje, “sepse nga humnera të kërkoj Ty, Zot”, “mi fal mëkatet e mia”, “ma krijo zemrën e pastër”, “më pastro krejtësisht nga faji im” – sepse tani besoj se Ti je Shpëtimtari im, Zoti im, Zotëria im, dhe e vetmja Paqe e vërtetë!

I bie mohit, i bie mohit Djallit, e Ti me forcën e Emrit Tënd të shenjtë dëboje nga shpirti im, dhe më mbush me Shpirtin Shenjt.

U bie mohit të gjitha veprave të tija: mëkatit, fallit, magjisë, shortisë, hajmalive thirrjes së shpirttrave, “syrit të keq”, varësive mëkatore: drogës, duhanit, alkoholizmit, robërisë televizi-onit, kompjuterit dhe inetnetit, okupimit të tepërt me sport, me muzikë negative, horosko-pit, jetës së natës, modës së papërvuajtë pagane, shqetësimeve djallëzore, bllokimeve dhe posedimeve – çdo sëmundjeje fizike, shpirtërore, psikike e morale, si dhe njerëzive të këqij, që i shërbejnë Djallit!

Shpëtimtari im, Zoti im! Të falem nderit, Të falem nderit, Të falem nderit – që ma jep paqen dhe lirinë e fëmijëve të Zotit!

Jezus, dashuria Jote është më e mirë se vetë jeta, goja dhe zemra ime do të Të lavdërojnë gjithmonë!

Madhëroje, shpirti im, Zotin!

## 11. Lutja e faljes

Po e dorëzoj, o Zot, dashurisë Sate ... (*thuaj emrin e personit që të ka shqetësuar*). Sipas shembullit të Jezusit, edhe unë po Të lutem: Fale, o Atë, sepse ai (*ajo*) nuk di çka bën! Në emër të Jezusit dërgoje atij (*asaj*) dashurinë tënde, shëroji plagët e tij (*saja*), për shkak të cilave ai (*ajo*) i plagos të tjerët. Dashuria jote le ta shkrijë lëvozhgën e së keqes që e mbulon, sepse Ti atë e ke krijuar në përngjasimin Tënd. Ai (*ajo*) nuk është objektivisht i (*e*) gjallë derisa nuk e shndrisë drita jote.

Dashuria ime që fal, le ta lirojë nga barra e tij. O Zot Jezus, shpërbleje dhe shndërroje me dashurinë Tënde! Sikurse unë e largova një gur nga rruga e dashurisë Sate, ashtu edhe dashuria Jote le të më mbush mua me paqen të shërim. Amen.

## 12. Lutja për falje

*Në këtë lutje do të jenë të përfshira shumë fusha të jetës. Është shumë me rëndësi që të shprehim me fjalë, në mënyrë të drejtpërdrejtë, faljen tonë JEZUSIT, ose personit tjetër, sikur të ishte i pranishëm në JEZUSIN.*

*Teksti i kësaj lutjeje do t'ju përkujtojë në personat të cilët duhet t'i falni. Shpreheni ate me fjalë, Le të veprojë lirisht Shpirti Shenjt dhe le t'ju udhëheqë deri tek personat ose grupet e njerëzve, të cilët duhet t'i falni.*

O Zot Jezu Krisht, po Të lus për mëshirën që të mund t'i fal sot të gjithë në jetën time. E di se Ti dëshiron të më japësh forcën për falje, dhe unë Të falënderoj se më do më shumë se unë vetveten, se e dëshiron lumturinë time më shumë se unë.

O Zot, unë ia fal **vetvetes** të gjitha mëkatet, të metat dhe gabimet: çdo gjë që me të vërtetë është e keqe ose që unë mendoj se është e keqe. E fal veten për pjesëmarrje në praktikat okulte, horoskop, astrologji, lexim nga shupla-ka, fall, magji. Unë kërkoj falje dhe unë e fal veten, për marrjen nëpër gojë të emrit Tënd pa nevojë. Më fal për mungesën e frikës së Zotit dhe të adhurimit.

Më fal për të gjitha lëndimet e prindërve të mi, për dehjen, duhanin, drogën; për mëkatet kundër pastërtisë (*pamoralitetin dhe abortin*); për të gjitha hajnitë dhe gënjeshttrat. Unë sot me të vërtetë e fal veten. Të falem nderit, o Zot, për mëshirën e vërtetë, të cilën po e marr pikërisht tani.

E fal krejtësisht **nënë time**. Po, unë, e fal për të gjithë kohën kur më ka lënduar, zemëruar, është hidhëruar në mua, dhe kur më ka dënuar; e fal se u ka treguar më shumë dashuri vëllëzërve dhe motrave të mia. E fal që më ka thënë se jam i marrë, i shëmtuar, fëmija më i keq, e fal se më ka thënë se nuk jam fëmijë i dëshiruar por vetëm rastësi ose gabim. Unë e fal me gjithë zemër.

E fal **babain tim** për mungesën e ndjenjës dhe të kujdesit, për mungesën e mbështetjes dhe të dashurisë. E fal se nuk ma ka kushtuar kohën për t'u shoqëruar me mua. E fal për dehjen dhe grindjet me nënën time dhe me të tjerët. E fal për dënimet, për braktisjen e nënës sonë dhe të shtëpisë sonë. Tani dëshiroj t'ia fal të gjitha.

O Zot, unë i fal **vëllëzërit dhe motrat e mia**. I fal ata që më kanë refuzuar, më kanë gënjyer, më kanë urreyer, ose

më kanë rrahur; ata që kanë qenë të vrazhdë me mua ose ma kanë rënduar jetën. Dua që t'i fal të gjithë.

O Zot, po e fal të fejuarin tim (*të fejuarën time*), për mungesë dashurie, ndjenje, nderimi dhe mbështetje, kujdesi, komunikimi, për gabimet e dobësitë dhe për punë ose fjalë të tjera, që më kanë lënduar ose shqetësuar dhe kanë ngarkuar ndërgjegjen time.

Jezus, po e fal **bashkëshortin tim** (*bashkë-shorten time*), për të gjithë mungesën në kujdes dhe dashuri, të gjitha fjalët e rënda, akuzat, për heshtjen vrasëse, dyshimet, xhelozinë, mospajtimin, shkeljen e ligjit të Zotit në jetën bashkëshortore, për mungesë të mbështetjes në edukimin e fëmijëve.

Jezus, i fal **fëmijët e mi** për mungesën e nderimit, dëgjuesës, dashurisë, kujdesit, mbështetjes, ngrohtësisë dhe mirëkuptimit, shpre-hitë e tyre të këqija, ose për mospraktikimin e fesë, për veprat e këqija dhe lëshime që më shqetësojnë.

Zoti im, unë e fal **birin** (*bijën*), **dhëndrin** (*nusen*) dhe të gjithë të afërmit tjerë, të cilët janë sjellë ndaj fëmijëve të mi me mungesë të dashurisë. Për të gjitha fjalët dhe veprat e tyre të cilat më kanë lënduar, unë tani i fal.

Të lutem, Zot, më ndihmo që t'i fal **të parët e mi**, gjyshen dhe gjyshin, të cilët janë përzier në familjen time, kanë lidhur për vete prindërit e mi, që ka sjellur përçarje në mes të prindërve të mi.

Jezus, më ndihmo që t'i fal **bashkpunëto-rët e mi**, të cilët kanë qenë të pakëndëshëm dhe ma kanë bërë jetën e rëndë dhe të mjerë. Ua fal atyre që punën e vet ma kanë lënë mua, më kanë marrë nëpër gojë dhe nuk kanë dashur që të bashkëpunojnë me mua, ose kanë dashur që të ma marrin punën. Tani unë i fal.

Zot, e fal **punëdhënësin tim** që nuk më ka dhënë pagë të mjaftueshme, që nuk e ka çmuar sa duhet punën time, që ka qenë i vrazhdë dhe i pakëndëshëm me mua, që nuk e ka vlerësuar dhe lavdëruar punën time.

E fal tani **famullitarin tim** dhe meshtarët tjerë ose motrat e nderit për panjerëzinë e tyre; që nuk më kanë dhënë guxim dhe nuk më kanë nxitur me frymëzime dhe mësim të reja, që nuk më kanë angazhuar në punët e famullisë dhe për çdo plagë tjetër që më kanë shkaktuar, unë sot po i fal.

Zot, i fal të gjithë **profesionalistët** që më kanë lënduar, sidomos mjekun, infermieren, juristin, policin ... për të gjitha që më kanë shkaktuar unë i fal tani nga zemra.

O Zot, po i fal **mësuesit e mi**, arsimtarët dhe profesorët, ata të dikurshëm dhe të tanishmen, që më kanë dënuar, poshtëruar, qortuar, trajtuar padrejtësisht, përqeshur, quajtur të marrë e të çmendur dhe më kanë lënë në shkollë pas mësimi për dënim, që kanë qenë shumë të ashpër me mua.

Zot, i fal **shokët e mi** për mungesë të ndjenjës dhe dashurisë, që më kanë braktisur, ose kanë qenë të panjerëzishëm, kur kam patur nevojë për ndihmën e tyre, atyre që kanë huazuar të holla dhe kurrë nuk i kanë kthyer, atyre që më kanë marrë nëpër gojë dhe shpifur.

Zot Jezus, tani të lus për hirin e faljes për **personin i cili më së shumti më ka lënduar** në jetën time. Të lus për hirin e faljes për të gjithë që unë i konsideroj kundërshtarët dhe armiqtë më të mëdhenj, për ate që më së vështiri e

kam ta fal dhe të cilit i kam thënë se kurrë nuk do ta fal. Tani e kërkoj bekimin për të gjithë që më kanë fyer. O Zot, bëj diçka të posaçme për secilin prej tyre!

**Të falem nderit, Jezus,** për lirinë nga e keqja e mosfaljes! Le të më mbushë **Shpirti Yt i Shenjtë** me dritë dhe le të jetë e ndriçuar çdo fushë e jetës sime. Amen!

*(Lutu në gjuhë të ndryshme dhe lavdëroje Zotin lirshëm, në mënyrë spontane.)*

### 13. Lutja e shërimit

O Jezu, Shërues i plagosur: më shëro me anë të plagëve të Tua. (1 Pt 2, 24; Is 53,3-5).

O Jezu, me Gjakun Tënd të paçmueshëm m'i shlyej mëkatet e mia dhe mëkatet e të parëve të mi. (1 Gjn 1, 17; Hebr 9, 22).

O Zot Jezus, jepma frytin e ringjalljes Sate: më mbush me Shpirtin Tënd të Shenjtë!

### 14. Lutja për shërimin e trungut familjar

Zot Jezus, më vjen keq se nuk jam lutur më parë për të parët e mi, anëtarët e familjes sime. O Zot, më prano për përfaqësues të të gjithë anëtarëve, të të parëve të familjes sime në të dy anët.

Zot, po e shprehi keqardhjen për çdo vrasje, abort, grindje familjare për shkak të trashigimisë, që kanë shkatërruar lumturinë familjare. Po më vjen keq dhe i bie mohit çdo kontakti me praktikant okulte, e sidomos i bie mohit mëkatit kundër urrdhrit të parë të Zotit dhe nderimit të hyjnive të rrejshme. O Zot, ki mëshirë për mua, ashtu si edhe për të gjithë anëtarët e gjallë të familjes sime. Fali të gjitha mëkatet e të parëve të mi, dhe më liro nga të gjitha varësitë negative. Unë i lartësoj në dritën Tënde të amshuar, dhe Të lus që ta ndiejnë dashurinë dhe faljen time. Le ta përjetojnë edhe dashurinë e faljen Tënde.

Zot, merri që tani këta shpirtëra në lumturinë Tënde dhe mëkatet e tyre mos ta rëndojnë më familjen time. O Zot, ki mëshirë për të gjithë të parët e mi!

*(Është mirë që për këtë qëllim të kremtohen Meshë të shenjta.)*

### 15. Lutja e prindërve

O Jezus tejet i mëshirshëm, unë t'i dorëzoj fëmijët e mi. Askush tjetër nuk mund ta kuptojë dhëmbjen dhe ankthin tim dhe të më japë ndihmë më të mirë. Më jep hirin që të mund t'i ngris fëmijët e mi, sepse unë e di se pa ndihmën Tënde, përpjekjet e mia nuk do të sjellin fryt. Pastroji veprat e mia dhe më ndriço që t'i mësoj, e sidomos që t'ua jap gjithmonë shembullin e mirë.

Liroji nga mëkati, mësoji që të rriten në dashuri, ruaji nga shoqëria e keqe, ndihmoju në mësimin e tyre, bëji të njerëzishëm dhe të mëshirshëm ndaj të varfërve, të dëmtuarve dhe atyre që vuajnë. Ruaji në hirin shenjtëruës dhe në shëndet të mirë, ashtu që të mund të rriten në lavdinë Zotit, për të mirën e të tjerëve dhe për kënaqësinë e

prindërve të vet. Dhe kur pas vdekjes të vij para Teje, Gjykatësit tim, Nëna Jote le të kujdeset për fëmijët e mi. Unë premtoj se prej tani do të Të shërbej me besnikëri, do të shpresoj në Ty dhe do ta përcjell këtë devotshmëri në të tjerët. Amen.

### 16. Lutja për familje

O Zot Jezus, po Të falënderoj për secilin anëtar të familjes sime. Besoj se secili anëtar i kësaj familjeje është dhuratë e veçantë për mua. Të lutem: më fal se aq herë nuk jam sjellur me ta si me fëmijët e Tu. Fali secilit prej nesh mëkatet të cilat i kemi bërë kundër Teje dhe njëri kundër tjetrit.

Zot, po T'i dorëzoj problemet familjare, dhe të lutem, Jezus, që të ndërhysh dhe të rregullosh çdo gjë që nuk është mirë në familjen tonë.

*Thuaj qëllimet e veçanta:*

a) Ndarja në mes të burrit dhe gruas;

b) Mungesa e dashurisë në familjen tonë;

c) Shterpësia;

d) Kokëfortësia e fëmijëve;

e) Shprehitë e këqija të anëtarëve të familjes (droga, alkoholi, duhani);

f) Papunësia;

g) Shkurorëzimi;

h) Mungesa e lutjes;

i) Mungesa e respektit të shëndoshë;

j) Raportet e këqija me fqinjët;

k) Mungesa e përparimit ekonomik;

l) Mosrespektimi i ligjit

*dhe të gjitha qëllimet tjera...*

Eja o Zot Jezus, eja në jetën time, hyr në problemet e mia familjare. Rethoje secilin anëtar të familjes sime me engjëjt e tu, na mbro nga çdo tundimi i çdo së keqeje dhe rreziku. Dërgoje Shpirtin tënd me shumicë, ashtu që secili anëtar i familjes të jetë i përtërirë në përngjasimin Tënd dhe paqja e Shpirtit Shenjt le ta mbushë këtë shtëpi dhe le të qëndrojë me ne tani e përgjithmonë,

"Beso në Jezusin Zot dhe do të shelbohesh, ti dhe familja jote" (Vap 16, 31).

### 17. Për mbizotërim mbi sjellje të këqija, vese dhe gabime

Na ruaj, o Zot, nga çdo shpirtvogëlsi, që të jemi të mëdhenj në mendime, fjalë dhe vepra. Na ndihmo që mos t'i kërkojmë gabimet dhe ta braktisim kërkimin e vetvetes.

Që t'i lëmë anash të gjitha arësyetimet dhe përvetësimet e së drejtës dhe të ballafaqohemi me vetveten sy më sy, pa vetëdhëmbshuri dhe gjykim. Që kurrë të mos jemi të ashpër në gjykim, dhe që gjithmonë të jemi fisnikë dhe zemërgjërë. Që gjithmonë të kemi kohë për të gjitha gjërat dhe të bëhemi të qetë, seriozë dhe bujarë. Na mëso që t'i vëmë në jetë nxitjet tona më të mira që të ecim drejt përpara dhe të jemi të patrembur.

Na ndihmo që të kuptojmë se ka pak gjëra në jetë që na dallojnë, dhe që ka shumë asosh që na lidhin. O Zot, na ndihmo që të mos harrojmë që të jemi të dhëmbshur dhe të njerëzishëm. Amen!

## 18. Lutja për shërimin e vetvetes

*(Mund të përdoret vaji i bekuar)*

Atë, po lyhem me këtë vaj të bekuar në emër të Jezusit, Birit Tënd. Ai është bari Yt për të gjitha sëmundjet e mia. Bëj që nëpër vajin e bekuar të ndjej forcën shëruese të Shpirtit Tënd të Shenjtë, i cili derdhet mbi mua nëpër vdekjen dhe ngjalljen e Jezu Krishtit. Sikurse ky vaj depërton dhe shëron, ashtu Shpirti Yt i Shenjtë le të përfshijë tërë qenien time dhe le të largojë tërë terrin, mëkatin, ndjenjat e këqia dhe negative dhe le të më plotësojë krejtësisht me dritë shëruese. O Atë, më shëro krejtësisht në trup, psikë dhe shpirt për nderin dhe lavdinë Tënde. Amen!

## 19. Lutje për atë që u largua nga Zotit

O Atë qjellor, Të lutem në emër dhe nëpërmes Gjakut të Jezu Krishtit, që ta lirosh nga Djalli krijesën Tënde të robëruar.

Të lutem, o Zot Jezus: vendose kurorën tënde prej therrash rreth ... *(thuaje emrin e personit)* dhe tërhiqe kah Zemra Jote Tejet e Shenjtë, nën velin Tënd të dashurisë.

Mari, Nëna jonë, të lus për ndërmjetësimin dhe mbrojtjen Tënde tek Biri yt Hyjnor për te. Amen!

*(Lexo: Lk 15, 1-7)*

## 20. Lutja për shërim të trupit

O Atë qjellor, tani të drejtohem në mënyrë të posaçme.

Jam i krijuar me fuqinë tënde. Çdo herë kur marr frymë, çdo mëngjes kur zgjohem, çdo sekond, çdo orë, unë jetoj me forcën tënde.

Ati im, të lutem, tani më prek me të njëjtën forcë, sepse nëse më ke krijuar prej asgjëje, Ti sigurisht mund të më përtërisht.

Më mbush me forcën shëruese të Shpirtit tënd.

Më liro nga çdo gjë që më ngarkon.

Rregullo çdo gjë që nuk funksionon.

Mënjano çdo qelizë joproduktive.

Hap çdo arterie ose venë të mbyllur.

Shëro çdo nerv dhe përtërij çdo pjesë të dëmtuar.

Bëj që të largohet çdo kallje dhe më liro nga çdo infeksion.

Le të kalojë ngrohtësia e dashurisë sate shëruese nëpër mua dhe të përtërijë çdo pjesë të sëmurë, ashtu që trupi im të funksionojë në atë mënyrë që Ti e ke caktuar, kur e ke krijuar.

Atë, përtërije shëndetin tim në trup dhe në shpirt, ashtu që të mundem prej tani të shërbej Ty tërë jetën.

Këte po të lus në emër të Jezusit, Zotit tonë. Amen!

## 21. Lutja për shërim të brendshëm

Jezus, të lutem, hyr në zemrën time dhe më liro nga ato përvoja jetësore që më kanë ngarkuar. Ti më njeh më mirë sesa unë vetveten.

Prandaj po Të lutem që të sjellësh dashurinë tëndë në çdo skutë të zemrës sime. Kudo që në mua të zbulosh fëmënë e lënduar, më prek me butësi, më ngushëllo dhe më liro nga çdo dhëmbje. Kalo nëpër jetën time deri në momentin kur jam ngjizur dhe liro trashëgiminë time trupore dhe shpirtërore, që ka mundur negativisht të ndikojë në atë çast.

Bekoje fillimin e zhvillimit tim në kraharorin e nënës sime dhe largo çdo gjë që më ka lënduar deri në këtë kohë. Kompenzo dallimin në mes të dashurisë që kam marrë dhe dashurisë që më është nevojitur.

Jezus, të lutem, mbështjelle fëmijërinë time të hershme me dritën tënde dhe shëro kujtimet që më kanë penguar.

Nëse pata nevojë për më shumë dashuri amënore, dërgoje Nënë tënde Marinë që të plotësojë ate që më mungon.

Nëse pata nevojë për më shumë dashuri atërore dhe siguri, më trego se kam qenë i dëshiruar dhe i dashur prej Teje në mënyrë më të thellë, më tërhiq kah vetja, që të ndjej mbrojtjen e duarve të Tua të forta. Përtërije besimin tim dhe forcën time që të ballafaqohem guximshëm me vështirësitë e kësaj bote, sepse unë e di se dashuria e Atit tim do të më ngrisë nëse rrëshqas dhe rrëzohem.

Të falem nderit, Jezus!

## 22. Lutja për nevoja materiale

Jezus, Zot, po vij tek Ti me brengat e kësaj bote dhe me vështirësitë materiale. Po t'i paraqes të gjitha problemet e mia financiare, të voglat dhe të mëdhatë. Në emër të Jezusit le të ndërpritet çdo ndikim i Djallit mbi to.

Më jep hirin që të mirat t'i përdor për lavdi më të madhe të Zotit. Më mëso që t'i përdor të mirat materiale sipas vullnetit të Zotit. Bëj që të mund t'i jap Zotit dhe Cezarit. Më mëso që t'i përdor të mirat materiale që i kam në disponim me ndjenjën e përgjegjësisë së plotë. Më beko që të mund të jem besnik në gjëra të vogla dhe të mëdha. Bëj që të kuptoj se jam vetëm mbarështues i gjërave që Ti m'i ke besuar. Më mëso që të përdor gjënë e besuar ashtu si Ti dëshiron.

M'i fal mëkatet e mia në fushën materiale. M'i fal të gjitha mëkatet e shkapërderdhjes, moskthimit të borxheve, kamatat e larta, krijimin e profitit të lartë, tregun e zi, grumbullimin e mallit, krenarinë me gjërat materiale, shkatërrimin e të mirave të huaja, mashtrimin, matjen e parregullt, ikjes nga tatimi dhe mosdarjes së lëmoshës.

Derdhe Gjakun Tënd tejet të çmueshëm në këtë fushë të jetës sime dhe më liro nga të gjitha problemet.

Të falem nderit Jezus! Aleluja!

## 23. Lutja për lirim nga robëria e djallit

Në emër të Jezu Krishtit Zot, le të largohen prej meje të gjitha forcat e territ, të robërisë së Djallit dhe të shprehive të këqija. Unë jam i Yti dhe i shpaguear me gjakun e Krishtit. Kurrfarë forcash të errëta nuk kanë pushtet mbi mua. Unë i takoj Jezu Krishtit. I urrdhëroj shpirtit të keq të sëmundjes, fatkeqësisë, të fatalizmit, që të largohen në emër të Jezusit. Le të jenë të lidhur nën kryqin e Krishtit dhe që kurrë të mos kthehen. Më pastro mua, dhe çdo gjë që më takon, me Gjakun tënd të paçmueshëm. Ndërmjetësimi i Virgjërës së Lume Mari dhe i shenjtërve të Tu Pjetrit dhe Palit le të jenë streha dhe mbrojtja ime. Le të jenë me mua lutjet e shenjtërve, apostujve dhe martirëve.

Le të më çojë Jezusi Zot kah jeta e pasosur dhe plotësia e shëlbimit.

Të falem nderit, Jezus! Lavdi të qoftë, Jezus!

*(Lavdëroje Zotin së paku disa minuta me dhuratën e gjuhëve! Mund të përdoret uji ose vaji i bekuar duke bërë shenjën e kryqit).*

## 24. Lutja në çastet e vuajtjes

Jezus, ma kumto në këto ditë të vuajtjes, vullnetin e Zotit. "Lotët e mi mblidhi në rrëshiqin tënd! A thua s'janë të shkruar në librin tënd?" (Ps 56, 9), "sepse e di mirë se Hyji është me mua" (Ps 56, 10). Më eja në ndihmë me nxitim. Shkurtoji ditët e vuajtjes. Më liro nga kjo fatkeqësi. Më dhuro jetë të gjatë dhe paqe, që Të lëvdoj në paqe. Më liro që të jem dëshmitari Yt.

Të falem nderit, Jezus! Të lavdëroj, o Jezus! Alleluja!

## 25. Lutja e mirëbesimit ndaj Zemrës së Krishtit

Jezu Krisht Zot, Zemrës Sate tejet të shenjtë ia besoj këtë qëllim: ... *(këtu thuaje qëllimin)*. Vetëm më shiko, e atëherë bëj çka të duash me mua... Zemra Jote tejet e Shenjtë le të vendosë... Unë shpresoj në te... Unë llogaris me të... Unë i dorëzohem mëshirës së saj.

Jezus, Zot, Ti nuk do të më braktisësh. Zemra tejet e shenjtë e Jezusit, unë shpresoj në Ty. Zemra tejet e shenjtë e Jezusit, unë besoj në dashurinë Tënde ndaj meje. Zemra tejet e shenjtë e Jezusit, le të vijë Mbretëria Jote. O Zemra tejet e shenjtë e Jezusit, unë Të kam lutur për shumë hire, por veçanërisht Të lus për këtë hir. Vendose, o Jezus, në Zemrën Tënde tejet të shenjtë. Kur Ati Yt i Amshueshëm ta shohë të mbuluar me Gjakun Tënd tejet të shenjtë, Ai do të ma japë këtë hir, sepse kjo nuk do të jetë më lutja ime, por e Jotja. O Jezus, o Zemra tejet e shenjtë e Jezusit, unë shpresën time e kam në Ty. Mos lejo kurrë që të turpërohem. Amen.

## 26. Lutja e të vetmuarit

O Zot, Atë i amshuar, më mbush me dashurinë dhe dashamirësinë tënde të pakufi. Bëj që të jem i kyçur në dashurinë Tënde. Më liro nga ndjenja se askush nuk më do. Merri nga unë ndjenjat e pikëllueshme se jam i padëshiruar.

Ti je streha ime. Atë i dashur, e shpalli me falënderim se ke dërguar të vetmin Birin tënd Jezu Krishtin për shpëtimin tim. Jezusi im i dashur, unë të lavdëroj, që më ke pastruar nga mëkati dhe më ke dhuruar dinjitetin e fëmijës së Zotit, me anë të vdekjes Sate në Kalvar. Oh, Shpirti Shenjt, dashuria e Zotit, eja e më mbush! Le të ndizet në mua flaka e dashurisë së Zotit dhe kurrë të mos fiket. Amen!

## 27. Shën Mihillit

O shën Mihill Kryeengjell, na mbro në ditë të luftës kundër djallit. Na ruaj nga shpirtligësia dhe nga kurthat e tija. Zoti ia mbylltë gojën!

Përvujtërisht po të lutemi ty, o Prijësi i Ushtrisë qiellore, që me fuqinë hyjnore ta dëbosh në ferr djallin dhe të gjithë shpirtit të këqij, që enden nëpër botë duke u vënë prita shpirtit për t'i shkatërruar.

O Mari, Mbretëreshë e engjëjve, lutu për ne!

## 28. Virgjërës Mari

*(Lutja e shën Bernardit)*

Le të bjerë në mend, o Virgjra Mari, tejet e mëshirshme, se kurrë nuk është dëgjuar që ndokush – që ka kërkuar mbrojtjen tënde, ka lypur ndihmën tënde, ose është lutur për ndërmjetësinë tënde – ka mbetur i padëgjuar.

I frymëzuar me këtë shpresë, po të drejtohem edhe unë ty, o Virgjër e virgjrave. Tek ti, o Nënë, po vij. Para teje rri unë, mëkatar i shkretë.

O Nënë e Fjalës së amshuar, mos i përbuz fjalët e mia, por i dëgjo dhe plot mëshirë m'i plotëso. Amen.

## S h t o j c ë

## 29. Kushtimi i ditës

O Zot, Ati ynë, po Ta kushtoj krejt ditën e sotme. Po t'i kushtoj lutjet, mendimet, fjalët, veprat dhe vuajtjet e mia në bashkim me Birin Tënd Jezu Krishtin, i cili po Ta kushton vetveten pandërprerë në Eukaristi për shëlbimin e botës.

Shpirti Shenjt, i cili e ka udhehequr Jezusin, le të bëhet sot edhe udheheqësi im dhe fuqia ime që të mund të dëshmoj dashurinë Tënde.

Me Marinë, Nënë e Jezu Krishtit dhe Nënë e Kishës, Të lutëm posaçërisht për qëllimet të cilat për këtë muaj i ka porositur i shenjtji Atë Papë në lutjet e të gjithë bësimitarëve. Amen.

## 30. Ankesa e Jezusit:

*»Njerëzit me shekuj më thërrasin "Jezus"  
(dmth. Shpëtimtar),  
por gjithmonë me aq pak dashuri!«*

I Shenjtë, tejet i lartë dhe i lavdëruar është Emri Im në Qiell dhe i nderuar në tokë. Në tingullin e Emrit Tim, i gjithë ferri ikën, dhe ai që Më thërret, ai që Më do me gjith zemër, gjen ate që i mungon, ngushëllohet në pikëllimet e tija dhe i hap zemrën e vet shpresës.

Atij që Më thërret me dashuri dhe me besim, Unë kam vendosur që t'i jap shpërblim të posaçëm në Qiell. Sa herë të Më thërrasë në tokë, aq herë do të jetë i lavdëruar nëpër të gjithë të lumturit në Qiell.

Por Ai që Më thërret i shqetësuar ose nga shprehia, çka pret nga Unë, nëse fare nuk ndalet në Emrin tim? Emri im nuk jep forcë nëse ju nuk Më doni. Ai nuk mund të zgjojë ndjenjat e dhëmbshurisë nëse nuk është thënë më shumë me zemër se me buzë.

Kush e njeh pushtetin që fsheh në vete ky Emër që ma dha Ati im? Kush e njeh gëzimin që përmban ky Emër që i ishte kumtuar Virgjërës, Nënës sime?

Me shekuj njerëzit më thërrasin "Jezus", por gjithmonë me aq pak dashuri! Sa shumë litani të personave të shqetësuar ngriten deri tek veshët e mi të ndjeshëm dhe të kujdesshëm! Por, pse nuk më kuptojnë? Pse nuk mendojnë se Unë i vetmi bart atë Emër të shenjtë, atë Emër që ka ëmbëlsinë e mjaltit, atë emër që është shpëtimi dhe dashuria?

Më thirrni gjithmonë me besim, duke mos menduar në hiret e dëshiruara, atëherë sa më pak që të kërkoni, aq më shumë do të merrni. Më thirrni gjithmonë, sepse Unë dëshiroj që të jem me ju dhe t'ju jap të gjitha. Në çdo moment, ditë e natë, në punë, nga të gjitha anët, Më thirrni, por me dashuri dhe me zemër: **Jezus!** Dhe Unë do t'ju ndihmoj, do t'ju liroj, sepse Emri im do të thotë: **Zoti që shpëton!**

*(Jezusi Catalanës, Bolivi. Nxjerrë nga libri: "Ushtria e madhe e dashurisë së kryqit", fq. 177.)*

## 31. Lutja në emër të Jezusit

Në Emër të Jezu Krishtit marr pushtet mbi çdo forcë dhe fuqi të shpirtit të keq – në ajër, në tokë dhe në nëntokë, në këtë dhe në atë botë.

Ti, o Zot, je mbi mbarë rruzullimin. Po të lavdëroj në emër të të gjitha krijesave. Në emrin tënd lidhi çdo shpirt djallëzor që ka ardhur kundër nesh dhe kundër familjeve tona dhe vë të gjithë ne nën mbrojtjen e Gjaktit Tënd të paçmueshëm, i cili është dedhur për ne në kryq. Mari, nëna jonë, kërkojmë mbrojtjen tëndë dhe ndërmjetësimin e Zemrës sate te Zemra tejet e shenjtë e Jezusit, për të gjitha familjet tona. Na mbulo me hirin tënd që të frikësohet armiku. Shën Mihill dhe Engjëjt tanë Rojtarë, ejani dhe ndërmjetësoni, na mbronin ne dhe familjet tona në luftë kundër çdo së keqeje që e përshkon botën.

Në Emër të Jezusit u urdhëroj të gjitha forcave dhe fuqive të së keqes që të largohen në këtë moment prej nesh, nga shtëpitë tona dhe nga atdheu ynë.

Ne të falënderojmë, o Zot Jezus, sepse je Hyj besnik dhe bashkëndjen me ne.

## 32. Lutja për largimin e të Keqit

*(Këtë lutje, si egzorcizëm privat, e ka lutur i lumi kard. Alojz Stepinac, për çdo mëngjes dhe mbrëmje. E ka porositur dhe të tjerëve, sidomos meshtarëve, eprorëve të bashkësive, kryefamiljarëve... me kryq të bekuar në dorë dhe me fe të gjallë. Është shumë aktuale sot, në këtë eskalim të së keqes.)*

† Në emër të Hyjit Atë,

† Në emër të Hyjit Bir,

† Në emër të Hyjit Shpirt Shenjt,

† Në emër të Jezu Krishtit, të vetmit Zotit dhe Shpëtimtarit tonë,

† Në emër të Virgjërës Tejet të Lumtur Mari, Nënës së Tij dhe Nënës sonë:

të urdhëroj, Djall,

dhe çdo shpirti krenar, lakmues dhe eptor,

shpirt zemërimi, urrëjtjeje dhe i çdo vullneti të keq;

shpirt ankthi, frike, dëshpërimi dhe pikllimi;

shpirt rrene, mashtrimi, smire dhe zillie

dhe i çdo së keqeje tjetër,

që të largohesh nga unë *[nga kjo shtëpi, nga familja ime,*

*nga famullia ime, nga ipeshkvia ime, nga populli im, nga*

*(emri i personit), nga bota mbarë]*

dhe t'ia lirosh vendin Shpirtit Shenjt Ngushëllues!

*(Duke bërë shenjën e kryqit † në të katër anët):*

**Ja kryqi i Zotërisë! Le të zhduket pala kundërshtare! Ka fituar Luani nga fisi i Judës, rrënja e Davidit, aleluja!**

*(Puthet kryqi!)*

## 33. Lutja e shëlbimit

*(Ripërtëritja e fesë në Jezu Krishtin)*

O Zot, Jezu Krisht, eja në zemrën time, dëshiroj që të jesh zotëria i jetës sime, që kështu të mund të jem fëmijë i dritës dhe të të njoh si Shëlbuesin personal, sepse e di dhe besoj që ke vdekur në kryq për mëkatet e mia. Je rringjallur përsëri nga të vdekurit ditën e tretë dhe përsëri do të vish në lavdinë tënde. Besoj në faljen tënde dhe dëshiroj që të më ndihmosh që të kundërshtoj çdo tundim, i cili do të mund të më largonte prej dashurisë sate të amshuar.

## 34. Kushtimi së lumes Mari Virgjër

Virgjëra Tejet e Shenjtë Mari, nxënësja më e mirë e Jezusit, unë dëshiroj që t'ia kushtoj jetën time zemrës sate të Pamëkat. Me Jezusin dëshiroj që t'i lëshohem vullnetit të Atit qiellor, dhe të eci në fe me Ty, Nëna ime.

Ty ta besoj jetën time të brendshme. Unë ta fali çdo dhuratë që kam, të hirit ose të natyrës, trupin dhe shpirtin tim, çdo gjë që jam dhe çdo gjë që bëj.

Lutu për mua që Shpirti Shenjt të më mbushë me dhuratat e veta të shumta. Lutu me mua, që me anë të fesë ta njoh forcën e Krishtit dhe me dashuri ta bëj të dukshme për botën.